

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6458
E shtunë, 6 nëntor 2021
çmimi 0.40 €

Vazhdon transferimi i afganëve nga Kosova drejt ShBA-së

IFAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUAR TË AMERIKËS (SHBA) NUK E KANË FTUAR KOSOVËN NË SAMITIN E DEMOKRACIVE

IFAQE 4-5

SHBA-ja, 'SHUPLAKË' KOSOVËS, NUK E FTON NË SAMITIN E DEMOKRACIVE



Kosova nuk është ftuar nga Shtetet e Bashkuar të Amerikës (ShBA) të marrë pjesë në Samitin e Demokracive, i cili do të mbahet në muajin dhjetor në ShBA. Sipas gazetës amerikane "Politico", vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk kanë marrë ftesë janë Bullgaria, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Kosova. Mungesa e kësaj ftese për Kosovën është vlerësuar shqetësuese nga njohësit e rrethanave politike. Sipas tyre, kjo është një shuplakë që ShBA-ja ua ka dhënë institucioneve të Kosovës

OLIVER VARHELYI BËN THIRRJE TË VAZHDOJË DIALOGU KOSOVË - SERBI

IFAQE 7



PSD-ja: KURTI NUK BËRI ASNJË VEPRIM PËR TË VËNË DREJTËSI PËR ASTRIT DEHARIN

IFAQE 6

AKTUALE



KRYETARI I RI I NJU-JORKUT DËSHIRON TË PAGUHET ME BITCOIN

F. 2

440 RASTE AKTIVE ME COVID NË KOSOVË

F. 3

KONJUFCA: BE-JA NUK E PËRMBUSHI PREMTIMIN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

F. 7

EKONOMI



HAPET FUSHATA INFORMUESE "DITËT E BIZNESIT KOSOVAR"

F. 8

OKB-ja: ÇMIMET E USHOIMEVE, NË NIVELIN MË TË LARTË QË 10 VJET

F. 8

SPORT



BALLKANI DHE DRITA LUFTOJNË PËR POZITËN E PARË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kryetari i ri i Nju-Jorkut dëshiron të paguhet me bitcoin

NJU-JORK, 5 NËNTOR - Eric Adams, kryetar i zgjedhur i qytetit të Nju-Jorkut, ka thënë se dëshiron që tre çeqet e para të pagesës t'i marrë në bitcoin.

Ish-kapiteni i policisë u zgjodh këtë javë dhe do të marrë detyrën në fund të

mandatit të kryebashkiakut Bill de Blasio, në muajin janar.

Adams ka thënë në mediat sociale se dëshiron ta bëjë Nju Jorkun "qendër të industrisë së kriptomonedhave". "Në Nju Jork, ne gjithmonë bëjmë

hapa të mëdhenj, kështu që unë do t'i marr tre çeqet e para të pagës në bitcoin, kur të bëhem kryetar", ka shkruar Adams në një postim në "Twitter".

Ai ka theksuar se qyteti i Nju-Jorkut do të jetë qendër e industrisë së

kriptomonedhave dhe industrive të tjera inovative. Vlera e bitcoin-it, kriptomonedhës më të madhe në botë, ka qenë shumë e paqëndrueshme prejse është krijuar në vitin 2009.

Adams, demokrat, u zgjodh



të martën dhe do të bëhet kryetari i dytë me ngjyrë i qytetit.

24 senatore amerikane kërkojnë mbrojtjen e grave në Afganistan

WASHINGTON, 5 NËNTOR - Të gjitha anëtarët gra të Senatit të Shteteve të Bashkuara i kanë bërë thirrje presidentit amerikan, Joe Biden, që t'i mbrojtë të drejtat e grave dhe vajzave afgane, pas tërheqjes së ushtrisë amerikane nga Afganistani.

Në një letër dypartiake, 24 ligjvënëset amerikane, të udhëhequra nga demokratja Dianne Feinstein dhe republikania Joni Ernst, i kanë kërkuar administratës Biden të dalë me një "plan ndërinstitucional", që ruan të drejtat politike, sociale, ekonomike dhe themelore të grave dhe vajzave afgane.

Pasi kanë përmbysur qeverinë e njohur ndërkombëtarisht në Kabul, në mes të gushtit, talebanët kanë premtuar se do të jenë më të moderuar sesa gjatë sundimit të tyre brutal, nga viti 1996 deri më 2001, kur vajzat



nuk janë lejuar të shkojnë në shkollë dhe gratë nuk janë lejuar të punojnë jashtë shtëpisë.

Megjithatë, Kombet e Bashkuara dhe grupet e të

drejtave të njeriut kanë thënë se talibanët nuk i kanë mbajtur premtimet dhe i kanë kritikuar ata për vendosjen e "kufizimeve të gjera" si ndaj grave, ashtu

edhe ndaj mediave dhe fjalës së lirë. "Shkëputja e Amerikës nga Afganistani vë në rrezik përfitimet e siguruar me vështirësi për gratë dhe vajzat

afgane", kanë thënë senatoret e SHBA-së.

Ato kanë kujtuar se, vitin e kaluar, rreth 3.5 milionë vajza afgane janë regjistruar në shkollë dhe se 100 000 të tjera përdiqnin institucionet e arsimit të lartë. "Duke mos pasur qeveri legjitime dhe forca ushtarake afgane për t'i mbrojtur ato, gratë dhe vajzat tani vuajnë nga një regjim taleban, me histori brutalizimi, izolimi dhe mohimi të jetës dhe lirisë", thuhet në letrën e senatoreve. "Gratë kanë qenë viktime të rrahjeve dhe vrasjeve dhe u ndalohe të dalin nga shtëpia pa një kujdestar mashkull", kanë thënë ato.

Senatoret kanë thënë se plani i administratës Biden duhet të trajtojë mënyrën se si Shtetet e Bashkuara do të punojnë me organizatat ndërkombëtare, të tilla si Kombet e Bashkuara për t'i mbajtur talebanët përgjegjës.

Gjendet i vdekur një diplomat rus në Berlin

BERLIN, 5 NËNTOR - Një diplomat rus i dyshuar si agjent i fshehtë i shërbimit të inteligjencës është gjetur i vdekur para Ambasadës së Rusisë në Berlin muajin e kaluar, raportuan mediat gjermane më 5 nëntor.

Më 19 tetor, policia gjermane në Berlin e ka gjetur trupin e pajetë të diplomatit para ndërtesës së ambasadës, raporton "Der Spiegel".

Pasi mediat raportuan për këtë rast, Ministria e Jashtme e Gjermanisë përmes një zëdhënësi, tha se janë në dijeni për rastin por nuk mund të ofrojnë më shumë detaje. Gazeta gjermane në raportin e


saj tha se shtetasi rus, 35-vjeçar, besohet se ka rënë nga kati i sipërm i ndërtesës së ambasadës, e cila gjendet në qendër të Berlinit. Ambasada ruse nuk është pajtuar që trupit të pajetë të punonjësit të saj t'i bëhet autopsia.

Statusi diplomatik që kishte ai u pamundëson prokurorëve gjermanë të zhvillojnë një hetim, raportoi "Der Spiegel".

Bazuar në një listë zyrtare të diplomatëve të akredituar në Gjermani, ai figuronte si Sekretar i Dytë i Ambasadës. Megjithatë, zyrtarët gjermanë të sigurisë dyshojnë se ai ishte një agjent i Shërbimit Federal të

Sigurisë por që aktivitetin e tij e kishte mbuluar me pozitën e diplomatit, raportoi "Der Spiegel".

Mediat tjera, "Insajder" dhe "Bellingcat", megjithatë, thonë se përmes burimeve mund të vërtetohet se i ndjeri është Kirill Zhalo, djali i gjeneralit, Alexei Zhalo, shef i Zyrës së FSB-së për Mbrojtjen e Sistemit Kushtetues. Shërbimet perëndimore të inteligjencës e kanë ndërlidhur Kirill Zhalo me vrasjen e Zelimkhan Khangoshvili, ish-luftëtar separatist çeçen, që ka ikur nga Gjeorgjia në Gjermani, është qëlluar për vdekje në Berlin më 2019.



Papa emëron gruan e parë në një pozitë të lartë të Vatikanit

VATIKAN, 5 NËNTOR - Papa Françesku ka emëruar për herë të parë një grua në krye të divizionit administrativ të Vatikanit, tha Selia e Shenjtë.

Në njoftim thuhet se motra françeskane, Raffaella Petrini, u emërua sekretare e përgjithshme e divizionit - zyrës së dytë më të lartë të

qytetit të Vatikanit.

Petrini, 52 vjeçe, do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen e administratës, përfshirë muzetë e Vatikanit, zyrën

postare dhe policinë.

Françesku, 84 vjeç, ka thënë se dëshiron që gratë të luajnë një rol më të madh në Kishën Katolike Romake.



Kryetari i PDK-së: Kosova është krenare me Thaçin, Veselin dhe çlirimtarët e tjerë

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në njëvjetorin e ngritjes së aktakuzës ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka thënë se ata nuk janë këtu, por sot dhe përgjithmonë do të jenë historia e lavdishme e këtij vendi. Krasniqi përmes një postimi në logarinë e vet në "Facebook" ka

shkruar se kurrë dhe nga askush nuk mund të ndryshohet historia jonë dhe as të tjetërsohet e vërteta e luftës sonë çlirimtare e drejtë dhe e pastër. "Kosova është pafundësisht krenare me djemtë e saj patriotë, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin, e me shokët e tyre çlirimtarë, që bashkë me gjithë popullin, ndërruan epokë dhe shkruan rrëfimin e jashtëzakonshëm e madhështor

të mosnënshtrimit, të lirisë dhe të pavarësisë. E do ta shkruajnë edhe fitoren e kësaj beteje të fundit, për t'u kthyer në shtëpi si heronj", ka shkruar ai. Më 5 nëntor, Thaçi, Veseli dhe Selimi u transferuan në qendrën e paraburgimit të Dhomave të Specializuara me seli në Hagë. Ndërkaq, Krasniqi u transferua atje një ditë më parë, më 4 nëntor.



Lajçaku nga Samiti i Selanikut bën thirrje të hiqen vizat për Kosovën



PRISHTINË, 5 NËNTOR - I dërguari special i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, ka qenë pjesë e Samitit të Selanikut, ku ka theksuar se është e rëndësishme që BE-ja t'i heqë vizat për qytetarët e Kosovës. Ai ka folur për nevojën e nisjes së bisedimeve në mes të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Ndërkaq, ka thënë, po ashtu, se do të rekomandojë që të hiqen vizat për qytetarët e Kosovës. "Për mua pyetja nuk është nëse duhet, por kur dhe si hap të parë do të rekomandojë të nisim bisedimet pa shtyrje me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe të hiqen vizat për qytetarët e Kosovës", ka thënë Lajçak. Ndër të tjera, ai ka komentuar edhe situatën e fundit politike në Maqedoninë e Veriut, ku u shpreh se dorëheqja e kryeministrit Zaev

është për shkak se BE-ja nuk arriti ta përmbushë premtimin, ndërsa Bashkimi Evropian, sipas tij, "humbi një nga partnerët më të mirë në rajon". "Kryeministri Zaev i humbi zgjedhjet për shkak se nuk ka mundur ta përmbushë premtimin e tij për fillim të bisedimeve me Bashkimin Evropian, ndërsa premtimin e tij nuk e përmbushi jo për shkak se nuk kishte kryer pjesën e tij, por për shkak se ne, Bashkimi Evropian, nuk kemi mundur ta përmbushim pjesën tonë. Si pasojë e kësaj, humbëm një partner i cili ishte besnik ndaj idesë evropiane, konstruktiv dhe i përkushtuar, një nga partnerët më të mirë në rajon. Për mua është sinjal i qartë se rajoni nuk ka kohë për ta në pritje dhe është koha që Bashkimi Evropian të veprojë për shkak se do të humbë më shumë partnerë evropianë", është shprehur Lajçak.


440 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 5 NËNTOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 1 619 testimeve, 14 qytetarë

kanë rezultuar pozitivë me Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të premtën janë shëruar 17 qytetarë, derisa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 157 419. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 440. Në 24 orët e fundit janë dhënë 2 646 doza të vaksinës kundër

Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 578 022 doza të vaksinës. Deri më sot 737 475 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



QKMF-ja në Podujevë bëhet me autoambulancë të re

PODUJEVË, 5 NËNTOR - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Podujevë është pajisur të premtën edhe me një autoambulancë të re. Me rastin e arritjes së automjetit të ri në QKMF për vizitë qëndruan edhe

kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Driton Veliu. Kryetari Bulliqi tha se në vazhdimësi po përkrahet QKMF në Podujevë me

qëllim të përmirësimit të shërbimeve për pacientët llapjanë. Gjithashtu, është funksionalizuar aparatura moderne X-Ray, e cila bën fotografimin e dhëmbëve dhe tash e tutje pacientët mund ta shfrytëzojnë këtë shërbim në QKMF.





SHTETET E BASHKUAR TË AMERIKËS (SHBA) NUK E KANË FTUAR KOSOVËN NË SAMITIN E DEMOKRACIVE

ShBA-ja, 'shuplakë' Kosovës, nuk e fton në Samitin e Demokracive

Kosova nuk është ftuar nga Shtetet e Bashkuar të Amerikës (ShBA) të marrë pjesë në Samitin e Demokracive, i cili do të mbahet në muajin dhjetor në ShBA. Sipas gazetës amerikane "Politico", vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk kanë marrë ftesë janë Bullgaria, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Kosova. Mungesa e kësaj ftese për Kosovën është vlerësuar shqetësuese nga njohësit e rrethanave politike. Sipas tyre, kjo është një shuplakë që ShBA-ja ua ka dhënë institucioneve të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Gazeta amerikane "Politico" të premten ka publikuar listën e shteteve që janë ftuar të marrin pjesë në Samitin e Demokracive i cili do të mbahet në muajin dhjetor në ShBA. Në hartën e shpërndarë për vendet që kanë marrë ftesë nga Ballkani Perëndimor, Kosova nuk është pjesë e listës.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk kanë marrë ftesë janë edhe Bullgaria, Serbia, Bosnje-Hercegovina. "Lista e qeverive të ftuara nuk është bërë publike, megjithëse 'Politico' arriti të marrë një përmbledhje të enjten. Planet janë të gjitha tentative dhe grupet e shoqërisë civile po ankohen se janë të marginalizuara", ka shkruar gazeta amerikane.

Mungesën e ftesës për Kosovën në këtë samit e ka konfirmuar edhe Ambasada e ShBA-së në Kosovë. Një zëdhënës i Ambasadës Amerikane ka deklaruar për mediat se Samiti për Demokraci i presidentit Joe Biden është nismë e cila nuk

mund t'i akomodojë të gjithë partnerët. "Samiti i presidentit për Demokraci është një nga shumë nismat e ShBA-së, e përqendruar në avancimin e demokracisë, luftimin e korrupsionit dhe promovimin e respektimit të të drejtave të njeriut përrreth globit. Jo të gjithë partnerët mund të akomodohen në këtë nismë. Qëllimi ka qenë që të bëhet bashkë një grup rajonal e socio-ekonomik i vendeve e juridiksioneve, që i përfshin demokracitë me themele të mira si dhe demokracitë në shfaqje e sipër me llojllojshmëri të madhësisë së popullsisë, demografi e vendndodhje", ka thënë zëdhënësi i ambasadës.

Ai ka vlerësuar se ShBA-ja si partnere e palëkundur e Kosovës mbetet e përkushtuar për të punuar me Kosovën. "Si partner e palëkundur e Kosovës, Shtetet e Bashkuara mbetet e përkushtuar për të punuar me Kosovën në forume të tjera për avancimin dhe fuqizimin e demokracisë, parandalimin e regresit demokratik, promovimin e respektimit të të

drejtave të njeriut dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë që së bashku të mund të dëshmojmë se demokracitë i plotësojnë nevojat e popujve të tyre", ka thënë ai.

Ndërsa institucionet e Kosovës nuk e kanë komentuar mungesën e kësaj ftese nga ShBA-ja.

Qeveria urgjentisht të ndërrojë kurs, raportet me ShBA-në janë lënduar

Mungesa e ftesës për Kosovën në këtë samit ka nxitur reagime të shumta të njohëseve të rrethanave politike në vend. Sipas tyre, kjo është një shuplakë që ShBA-ja ua ka dhënë institucioneve të Kosovës. Analisti politik Ilir Ibrahimimi ka vlerësuar se mungesa e ftesës për Kosovën është shqetësuese. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se qeveria urgjentisht duhet të ndërrojë kurs, sepse raportet me ShBA-në janë lënduar. "Deri tani kemi dëgjuar apo parë mospajtime me zë të ulët nga administrata Biden ndaj

qasjes së Qeverisë së Kosovës. Lënia anash e Kosovës, si një nga 4-5 vendet evropiane që nuk ftohen në Samitin e Demokracisë 2021, është britmë. Presidentja brenda pak javësh ishte dy herë në ShBA dhe nuk e takoi asnjë zyrtar të administratës. Kryeministri i cili kishte deklaruar se do ta vizitojë ShBA-në në nëntor, e anuloi vizitën për shkak se, sipas disa burimeve, nuk arriti të sigurojë ndonjë takim me administratën", ka shkruar ai, duke shtuar se askush nuk e ka luksin që t'i vë në pikëpyetje interesat strategjike të Kosovës me ShBA-në. "Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet të ndërrojë kurs dhe t'i kthehet ndërtimit tanimë të lënduar të marrëdhënieve me aleatin kryesor. Askush nuk mund t'ia japë vetes luksin që për bindje ideologjike të vë në pikëpyetje interesa strategjike të vendit", ka shkruar Ibrahimimi.

Kurse gazetari Adriatik Kelmendi ka thënë se mosftesa për pjesëmarrjen e Kosovës në Samitin e Demokracive është lajmi më i keq për vendin kohën e fundit. "Lajmi më i keq i kohëve të fundit për Kosovën ndodhi sot. Me të vendosë Amerika e Bidenit në një grup me Serbinë e Vuçiqit, Bosnjën e Dodikut dhe Hungarinë e Orbanit është shuplaka më e rëndë që mund ta marrim. Mosftesa për pjesëmarrjen në Samitin e Demokracive është përgjigja e

Shtëpisë së Bardhë për papërgjegjësinë e lartë të Kosovës në planin e politikës së jashtme", ka shkruar ai.

Sipas Kelmendit, kjo shuplakë duhet t'i këndellë institucionet e Kosovës. "Nëse edhe kjo shuplakë nuk na kthjellë atëherë vërtet nuk meritojmë më mirë, mbesim gjysmështet/gjysmëhajgare, të vetmit pa liberalizim vizash, pa anëtarësime në organizatat ndërkombëtare, duke ia nxjerrë sytë njëri-tjetrit në geto mizerie", ka vlerësuar ai.

Edhe politologu Agon Maliqi ka vlerësuar se mungesa e kësaj ftese duhet të lexohet si kabanë alarmi. "Mirëmëngjesi popull liridashës. Kjo është sipas një raporti të Politico harta e shteteve në Evropë të cilave ShBA u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje në Samitin e Demokracive në dhjetor. Mospërfshirja e Kosovës është sinjal shumë i keq për nivelin e marrëdhënieve dhe duhet të lexohet si kabanë alarmi", ka shkruar Maliqi në profilin e vet në "Facebook".

"Politico" ka shkruar se kabineti i presidentit amerikan ende është duke bërë agjendën për samitin virtual të 9-10 dhjetorit dhe shumë prej punëve të tij janë konfidenciale. Sipas të dhënave të "Politico"-s, ky samit do të kulmojë me një takim tjetër në vitin 2022 ku do të diskutohen të arriturat e samitit të këtij viti.

Shpenzimet e partive gjatë fushatës, auditori: Disa gjetje janë shqetësuese



Prishtinë, 5 nëntor - Gjatë shqyrtimit të raporteve të auditimit të raporteve vjetore financiare dhe raporteve të deklarimit financiar të fushatës të subjekteve politike, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Hykmete Bajrami, ka thënë se shumica e raporteve të audituara janë të këqija. "Raportet në përgjithësi për të gjitha subjektet politike

nuk janë të mira. Sikur të kishim pasur auditime vit pas viti, gjendja do të ishte më e mirë, pasi që nuk ka pasur auditime që nga viti 2017. Jemi të shqetësuar për këtë vonesë, pasi që kjo çështje është edhe e gjetur nga Raporti i Progresit", ka thënë ajo. Derisa auditori Ymer Shatri nga kompania "Audit&Conto", që ka kryer këto auditime, ka thënë para deputetëve se për këto tri vjet kanë audituar subjektet

politike, ku janë dorëzuar 95 raporte të auditimit, prej tyre 21 raporte janë të pakualifikuara ose 50 për qind e këtyre raporteve shkojnë në mohim të opinionit. Ani pse tha se ka shkelje të ligjit nga subjektet politike, auditori foli edhe për partitë politike që kanë shënuar përparim në raportim. "Partia politike që ka bërë progres është sidomos PDK-ja. IV-ja ka pasur disa ndryshime.

Me partinë tjetër më të madhe nuk jemi shumë të kënaqur. Në anën tjetër ka gjetje nga subjektet që janë shqetësuese, ku kemi hasur në shpenzime që nuk janë në harmoni me Ligjin për Financimin e Partive Politike", ka thënë ai. Diskutime më të theksuara pati për subjektin politik të LV-së dhe të LDK-së. Vetëvendosja ani pse ka dërguar me vonesë raportin e

shpenzimeve për katër komunat veriore ku kishte marrë pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme, ka raportuar vetëm 3 500 euro shpenzime. Derisa për zgjedhjet e jashtëzakonshme në Podujevë që ishin mbajtur më 2020, LDK-ja ka paraqitur në raport zero shpenzime. Auditori ngriti edhe çështjen e mosraportimit për të hyrat e grupeve parlamentare. /KP/

Vazhdon transferimi i afganëve nga Kosova drejt ShBA-së



Prishtinë, 5 nëntor - Nga 1 307 shtetas afganë, të cilët kanë ardhur në Kosovë, 601 prej tyre janë larguar për në shtete të ndryshme. Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë ka njoftuar të premten se më shumë se 100 shtetas afganë që kanë qenë duke qëndruar përkohësisht në Kosovë, të premten janë nisur

drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në një shkrim të publikuar në rrjetin social "Twitter", Ambasada Amerikane e ka falënderuar Kosovën për mikpritjen e afganëve. "Mëngjesin e sotëm fluturimi i katërt u nis nga Kosova me mbi 100 afganë, të cilët së shpejti do të fillojnë një jetë të re në ShBA", thuhet në postimin e

ambasadës amerikane. Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se në Kosovë deri tash kanë ardhur 1 307 persona, aktualisht janë 706, kurse janë larguar 601 persona. Për sjelljen e afganëve në Kosovë apo largimin e tyre janë realizuar 34 fluturime aeroplanësh. Autoritetet e Kosovës kanë bërë

me dije se do t'i strehojnë rreth 2 000 shtetas afganë të cilët kanë punuar me Shtetet e Bashkuara dhe me shtetet aleate të NATO-s. Sipas ligjeve në fuqi, Kosova u ka dhënë qëndrim të përkohshëm deri në një vit. Për dallim nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, ku afganët që po gjejnë strehim atje, janë të lirë të lëvizin jashtë hapësirave ku ata janë të vendosur, për

afganët që strehohen në Kosovë ka masa më të rrepta të sigurisë. Forcat ndërkombëtare, që kanë operuar në Afganistan në 20 vjetët e fundit, janë tërhequr nga ky vend në fund të gushtit. Rreth 60 mijë persona që ikën nga ky shtet përmes fluturimeve ushtarake të organizuara nga ShBA-ja dhe shtetet e tjera aleate, përfunduan në vende të ndryshme të botës.

Komuna e Kamenicës jep 40 bursa me zbritje për "Bonevet" Kamenica

KAMENICË, 5 NËNTOR - Komuna e Kamenicës, përveç përkrahjes së vazhdueshme të "Bonevet", për ciklin e parë të klasave


nëntor-dhjetor, jep 40 bursa me zbritje 25 për qind. I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se projektet të cilat ndihmojnë

në përparimin dhe zhvillimin e fëmijëve do të kenë përkrahjen tonë gjithmonë. "Konceptet e tilla si 'Bonevet' ndihmojnë

zhvillimin dhe përparimin e fëmijëve të komunës sonë, prandaj edhe do ta kenë përkrahjen përherë", ka deklaruar Kastrati.



PSD-ja: Kurti nuk bëri asnjë veprim për të vënë drejtësi për Astrit Deharin



elektoral. Ai funksion u krye. Prandaj tash dëshiron ta mbajë në nivel homazhi. Në nivel përkujtimi. Tash kur janë në pushtet, më nuk thërrasin për drejtësi. Thërrasin për përkujtim. Edhe atë vetëm një herë në vit. Në përvjetorin e vdekjes së tij. Sepse sot thirrja për drejtësi për Astritin është thirrje që duhet t'ia drejtojnë vetes. Duhet t'i drejtohet qeverisë. Qeverisë Kurti. Sot Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu duhet të mbajnë përgjegjësi për mosveprim në vënie e drejtësisë në vend. Ose së paku duhet të pranojnë para qytetarëve të Kosovës që kanë mashtruar e keqpërdorur elektoralisht e politikisht, me vdekjen e shokut tonë, bashkaktivistit Astrit Dehari", ka deklaruar Frashër Krasniqi.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Partia Socialdemokrate në pesëvjetorin e vdekjes së Astrit Deharit ka bërë një aksion simbolik duke vendosur pankarta tek objekti i Qeverisë së Kosovës. Në këto pankarta janë shkruar deklarata që ishin bërë në lidhje me vdekjen e Astrit Deharit nga kryeministri Albin Kurti, kryekuvendari Glauk Konjufca, ministrja Albulena Haxhiu dhe ministri Xhelal Sveçla.

Pas vendosjes së pankartave para mediave ka folur aktivisti i PSD-së, Frashër Krasniqi. Ai ka thënë se ka dy vjet që Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu kanë pushtet, por s'kanë bërë asnjë veprim për ta vënë drejtësinë për Astrit Deharin. "Astrit Dehari. Emri të cilin Albin Kurti dhe Vetëvendosja nuk e hoqën nga goja për katër vjet rresht. Emri të cilin Albin Kurti e përmendi vetëm pasi vdiq. S'e zuri ngoje as atë dhe as rastin e padrejtë gjyqësor ndaj nesh, për dy muaj rresht

pas arrestimit tonë. Astrit Dehari. Emri të cilin Albin Kurti filloi ta përmendte vetëm pasi iu bë i përdorshëm politikisht dhe elektoralisht. Emri të cilin Albin Kurti nuk e përmendi më asnjëherë prej ditës kur e mori pushtetin me 51 për qind të votave. Ka dy vjet që Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu kanë pushtet. Ka tetë muaj që Albin Kurti dhe Albulena Haxhiu kanë pushtet. Mbi 51 për qind të pushtetit, por s'ka asnjë veprim për ta vënë drejtësinë për Astritin në vend. Kur vdekja e tij ishte e përdorshme, tri vjet pa drejtësi u dukeshin tepër shumë, zotoheshin që drejtësinë për të do ta kishin prioritet qeverisë, ankoheshin që pesëvjetori nuk duhet të na gjejë me kërkesën për drejtësi, flisnin për të në çdo tubim elektoral", ka thënë Krasniqi.

Ai ka shtuar se Vetëvendosja tash po bën homazhe nga pozita e një pushteti që nuk ka bërë asgjë për të sjellë drejtësinë për Astritin. "Për të Astriti kishte një funksion



Kurti, Konjufca dhe Vitia bëjnë homazhe te varri i Astrit Deharit

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufcën dhe kandidatin për kryetar të Prishtinës, Arben Vitia,

kanë bërë homazhe te varri i aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari. Bashkë me Kurtin, Konjufcën e Vitin ishin edhe familjarët e të ndjerit dhe

qytetarë të shumtë. Astrit Dehari vdiq më 5 nëntor të vitit 2016 në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, në rrethana ende të pasqaruara mirë.

AAK-ja në Fushë-Kosovë mbështet në balotazh Burim Berishën

FUSHË-KOSOVË, 5 NËNTOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Fushë-Kosovë, ka bërë me dije se do ta mbështesë kandidatin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryetar të kësaj komune,

Burim Berisha, në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale më 14 nëntor. "Pas konsultimit me të gjitha strukturat dhe anëtarësinë e AAK-së në Fushë-Kosovë kemi marrë vendim që në raundin e dytë të zgjedhjeve

lokale për kryetar të komunës së Fushë-Kosovës të mbështetim kandidatin e LDK-së, Burim Berisha. Vota e çdo anëtarit të AAK-së në Fushë-Kosovë nga sot konfirmon rreshtim të vullnetshëm të

elektoratit të saj për mbështetje të plotë të z. Burim Berisha, i cili më 14 nëntor 2021 përmes verdiktit të popullit do të jetë kryetar i komunës së Fushë-Kosovës", ka njoftuar dega e AAK-së në Fushë-Kosovë.



Oliver Varhelyi bën thirrje të vazhdojë dialogu Kosovë - Serbi

Komisionari i Bashkimit Evropian për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, Oliver Varhelyi, duke folur lidhur me pakon e zgjerimit të Komisionit të BE-së 2021, ka theksuar se në raportet e këtij viti shihet se BE-ja ka një agjendë të njëjtë me Këshillin e Evropës sa i përket çështjes së reformave në Ballkanin Perëndimor. Ai u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që ta vazhdojnë dialogun dhe ta përfundojnë me sukses normalizimin e marrëdhënieve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

BUDAPEST, 5 NËNTOR - Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, në përbërje të Saranda Bogujevci, kryesuese e delegacionit, njëherësh nënkryetare e Kuvendit, si dhe deputetit Enis Kervan, anëtar, njëherësh kryetar i Grupit Multietnik në Kuvendin e Kosovës, mori pjesë në takim të Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, i cili u mbajt më 3 dhe 4 nëntor në Budapest të Hungarisë. Gjatë këtij takimi një nga temat kryesore të diskutimit ishte "Mbështetja e një perspektive evropiane për Ballkanin Perëndimor", gjatë trajtimit të së cilës pjesëmarrësve iu drejtua Oliver Varhelyi, komisionar i Bashkimit Evropian për Fqinjësinë dhe Zgjerimin dhe anëtarë të delegacioneve nga rajoni. Duke folur lidhur me pakon e zgjerimit të komisionit të BE-së

2021, Varhelyi ka theksuar se në raportet e këtij viti shihet se BE-ja ka një agjendë të njëjtë me Këshillin e Evropës sa i përket çështjes së reformave në Ballkanin Perëndimor. "Siç mund ta dini, raportet e këtij viti përputhen plotësisht me metodologjinë e rishikuar të zgjerimit, të miratuar vitin e kaluar nga komisioni, si dhe katër parimet kryesore të tij: më shumë besueshmëri, më shumë parashikueshmëri, më shumë dinamizëm dhe drejtim politik më të fortë", ka theksuar Varhelyi. Komisionari Varhelyi veçoi edhe disa nga çështjet kryesore dhe hapat që i presin vendet e Ballkanit Perëndimor. Sa i përket Kosovës, ai tha se duhet të vazhdohet procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e saj, duke bërë kështu thirrje për një Kosovë pa viza. Lidhur me dialogun, ai tha se duhet të vazhdojë dhe të përfundojë me sukses për normalizimin e plotë të



marrëdhënieve. Në vazhdim, komisionari i BE-se tha se vendet e Ballkanit Perëndimor sfidë kryesore e kanë luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjatë takimit të Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci, fjalën e mori edhe drejtuesja e delegacionit të Kosovës, Saranda Bogujevci. Në fjalën e saj Bogujevci fillimisht rikujtoi adresimin e saj gjatë sesionit plenar në shtator, i cili u mbajt në Strasburg. "Në mënyrë që vendet e Ballkanit Perëndimor të vazhdojnë tutje, duhet të përqendrohen në vlerat evropiane, veçanërisht

ato që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe demokracinë", ka theksuar Bogujevci. Në vazhdim kryesuesja e delegacionit të Kosovës përmendi masat që ka ndërmarrë Kosova për vënien në fuqi të legjislacionit dhe implementimin e tij, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve pakicë. Më tutje ajo shtoi se Kosova ka nevojë për mbështetje për arritjen e përmbyshjes së objektivave për t'u bashkuar familjes evropiane. Bogujevci ka theksuar se Kosova është pjesë e Komisionit të

Venecias dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe se misioni i Kosovës do të kompletohet me anëtarësimin e saj në Këshillin e Evropës. Në vazhdim nënkryetarja e Kuvendit zhvendosi fokusin te çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën, duke ua rikujtuar edhe një herë të pranishmëve se Kosova mbetet i vetmi vend në rajon pa të drejtë të lëvizjes së lirë. Ajo ka pohuar se liria e lëvizjes do të kontribuonte më së shumti te të rinjtë, të cilët do të mund të kenë mundësinë të marrin përvoja nga jashtë për të ndihmuar në zhvillimin e mëtutjeshëm të vendit të tyre.

Konjufca: BE-ja nuk e përmbushi premtimin për liberalizimin e vizave

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Komisioni Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë ka mbajtur takimin e shtatë. Nën udhëheqjen e përbashkët të Mimoza Kusari-Lilës, kryetare e delegacionit të Kosovës, si dhe Romeo Franz, kryetar i delegacionit të PE-së, Komisioni Parlamentar për Stabilizim Asociimi, pas dy vjetësh, ka mbajtur në Kuvendin e Kosovës takimin e radhës. Kryetarja Kusari-Lila, pasi hapi takimin dhe falënderoi të pranishmit, kërkoi që të shtohet raporti i të dyja palëve. Sipas kryesueses Kusari-Lila, rruga drejt BE-së është e pakontestueshme dhe dëshirë e pareshtur e qytetarëve të Kosovës. Për t'i uruar mirëseardhje delegacionit në fjalë, para të pranishmëve fjalën e mori kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i cili shpalosi gjendjen aktuale të raporteve në mes të Kosovës dhe BE-së.

Duke trajtuar kronologjikisht procesin dhe hapat që Kosova ka ndërmarrë drejt arritjes së objektivave që ndikojnë direkt në integrimin evropian, Konjufca ka shprehur gatishmërinë e plotë të Kuvendit për t'i shtyrë përpara të gjitha çështjet që lidhen me këtë proces. Ai, po ashtu, ka treguar se ka pasur edhe ngecje në zbatimin e plotë të objektivave të marrëveshjeve të arritura deri më tash për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe mungesës së stabilitetit të skenës politike në Kosovë. Konjufca ka theksuar se Kosova tashmë ka hyrë në fazën e mesme të periudhës kohore të zbatimit të MSA-së, por arritja e objektivave që burojnë nga kjo marrëveshje, sipas tij, kërkon ende shumë punë. Duke folur lidhur me procesin e integritit evropian, kryetari i Kuvendit të Kosovës ka thënë se pika më kritike e kredibilitetit aktual të BE-së ka të bëjë me strategjinë e zgjerimit. Ai nënvizoi se sa më shumë që



zgjerimi iu ka afruar Ballkanit, aq më shumë është ngadalësuar ai. "U bënë tetë vjet nga koha kur shteti i fundit iu bashkua BE-së. Nuk mbaj mend këtë dekadën e fundit që koncepti i zgjerimit të ketë qenë në krizë më të thellë se sot. Mungesa e një vizioni të guximshëm e të qartë po i prodhon dy pasoja të rrezikshme këto vitet e fundit. Së pari krijimin e një hapësire për projektet alternative që vijnë nga bota jodemokratike si Rusia e

Kina. Dhe, së dyti, fuqizimin e liderëve euroskeptikë në rajon, të cilët BE-në e shohin si projekt pa perspektivë dhe ngarendin ta përmbyllin agjendën e tyre etnonacionaliste siç po e shohim këto ditë në Bosnje dhe Hercegovinë", është shprehur Konjufca. Ndër të tjera, Konjufca ka shpalosur edhe qëndrimet e tij lidhur me mosliberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës, duke përmendur se BE-ja nuk e ka përmbushur premtimin e

dhënë dhe se pikërisht kjo dëmton kredibilitetin e institucioneve evropiane në sytë e qytetarëve të izoluar. "Republika e Kosovës është fuqishëm e përcaktuar për BE-në dhe ne nuk kemi projekt tjetër alternativë. Ne as nuk e shantazhojmë BE-në, as nuk e përgjetojmë. Ne duam ta meritojmë atë me punë, me reforma dhe angazhim konkret për drejtësi dhe barazi", ka thënë Konjufca.

Ambasadori italian thotë se do ta mbështetin qeverinë për ta përmirësuar jetën e qytetarëve



PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka pritur të premten në takim ambasadorin e ri të Italisë në Kosovë, Antonello De Riu, me të cilin ka diskutuar rreth programit qeverisës, pakos së ringjalljes ekonomike dhe projektligjit për buxhetin e vitit 2022.

Ministri Murati e ka mirëpritur ambasadorin De Riu dhe ka paraqitur punën e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke u fokusuar në masat e pakos së ringjalljes ekonomike, menaxhimin e mirëfilltë të financave publike dhe rritjen ekonomike që ka pasur vendi muajt e fundit.

Ambasadori De Riu ka theksuar se ka ndjekur me vëmendje zhvillimet e fundit në vend, e

sidomos projektligjin për buxhetin 2022, i cili drejtpërdrejt synon arritjen e objektivave të parapara në programin qeverisës 2021-2024.

Ministri Murati gjatë takimit e ka njoftuar ambasadorin De Riu për gjendjen me situatën pandemike, duke theksuar se qeveria ka ndërmarë një varg masash për kontrollin e pandemisë duke e bërë Kosovën vendin me popullsinë më të vaksinuar në regjion.

Ambasadori De Riu ka falënderuar ministrin Murati për pritjen dhe ka theksuar se do ta mbështetin qeverinë Kurti për arritjen e qëllimeve për përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës si dhe do ta vazhdojnë rritjen e bashkëpunimit në mes të dy vendeve.

Hapet fushata informuese “Ditët e biznesit kosovar”

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka bërë hapjen zyrtare të fushatës informuese “Ditët e biznesit kosovar”, ku përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë do të organizojnë shtatë javët e biznesit në qendrat kryesore të Republikës së Kosovës.

Në hapjen e kësaj konference ishte edhe kryeministri Albin Kurti dhe Rozeta Hajdari, ministre e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, të cilët thanë se konferenca në fjalë është mjaft informuese për zhvillimin e sektorit privat, përmes së cilës do

të bashkëbisedojmë me sektorin privat, për nevojat, sfidat, mundësitë, ndikimin e pandemisë në ekonomi dhe trendët e ekonomisë.

Pjesë e panelit të kësaj konference ishte edhe drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, i cili gjatë fjalës së tij tha se ky institucion krahasohet me vendet më të zhvilluara në rajon. Ai ka thënë se platforma digjitale e shërbimeve për tatimpagues deri më tani përfshin rreth 98 për qind të shërbimeve, së cilës shumë shpejt do t'i shtohen edhe dy komponentë shumë crucialë për tatimpagues, që do ta rritin transparencën, por edhe do të ofrojnë lehtësi për tatimpaguesit.



OKB-ja: Çmimet e ushqimeve, në nivelin më të lartë që 10 vjet



NJU-JORK, 5 NËNTOR - Çmimet e ushqimeve në gjithë botën kanë arritur nivelin më të lartë në më shumë se një dekadë, pasi janë rritur për më shumë se 30 për qind gjatë vitit të kaluar, ka njoftuar Organizata për Ushqim dhe Bujqësi e Kombeve të Bashkuara (FAO). Sipas saj, për rritjen e çmimeve kanë kontribuar ndërprerjet e furnizimeve, mbyllja

e fabrikave dhe tensionet politike. FAO ka njoftuar se çmimet e drithërave janë rritur për më shumë se 22 për qind, krahasuar me një vit më parë.

Çmimi i grurit ishte një nga kontribuuesit kryesorë në këtë situatë, pasi u rrit për 40 për qind në 12 muajt e fundit. Sipas FAO-s, kjo ka ndodhur pasi eksportueset kryesorë, Kanadaja, Rusia dhe

ShBA-ja, kanë pasur korrje të dobëta. “Kemi pasur vite mjaft të këqija të korrjeve në shumë vende”, ka deklaruar për “BBC-në” Peter Batt, ekspert i agrobiznesit në Shkollën Curtin Business në Perth të Australisë.

FAO ka njoftuar se çmimi i vajit bimor u rrit nga rritja e kostonë së vajrave të palmës, sojës, luledielliit dhe farave.

Ftohen gastronomët të pajisen me arkë fiskale

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Nismës për ta përmbyllur procesin e fiskalizimit i është bashkuar edhe Petrit Kllokoqi nga Shoqata e Gastronomëve. Në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në “Facebook”, Kllokoqi u ka bërë thirrje të gjitha bizneseve që merren me

gastronomi që t'i blejnë arkat fiskale prej 9.99 eurosh, meqë ky është çmimi më i lirë për të punuar në formalitet.

Kllokoqi ka përmendur vështirësitë e krijuara me situatën pandemike.

Nisur nga kjo, për kreun e gastronomëve kjo shoqatë

duhet të mobilizohet që t'i krijojë vetes kushte më të mira të punës dhe mundësi më shumë për të bërë biznes, e kjo duhet të nisë me fiskalizim të të gjitha bizneseve që merren me këtë fushë, duke e cilësuar si sektorin e dytë (jozyrtarisht) të punësimit në vend.



Një goditje për Kosovën



Shkruan: Adil BEHRAMAJ

Aktivitetet politikë e nisën dhe u burgosën. Studentët e vazhduan dhe dolën para tankeve. Populli lidhi krahët dhe protestoi. Qëlloheshin me armë. Shtypeshin me dhunë. Por, turmat veç sa rriteshin. Pakënaqësitë shpërthyen. Lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës si shpresë e re, të cilën në Hagë tani po na e quajmë Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale. Ky do të mund të ishte një rrëfim i shpejtë për fatin dhe fatkeqësinë tonë si popull deri te liria dhe pavarësia...

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi me bashkëluftëtarët e tyre në Hagë e në Kosovë ishin vënë në ballë të luftës kundër padrejtësive shumëvjeçare. Megjithatë, tani vetë ata po përballen me një padrejtësi të re. Dilema shekullore e Shën Agustinit se çfarë është sovraniteti, në mungesë të drejtësisë, përveçse grabitje e organizuar, mori edhe më shumë kuptim më 5 nëntor 2020. Që të katërtit u morën në mënyrë të organizuar dhe u dërguan në Qendrën e Paraburgimit në Hagë.

Ata që e promovojnë "Gjykatën e ndërgjegjes", në fillim e kishin një mënyrë shumë të thjeshtë të të kuptuarit të drejtësisë: njerëzve duhet t'u jepet ajo që e meritojnë. Megjithatë, vështirësia e vërtetë u fillonte me të kuptuarit se kush meritonte çfarë dhe pse?

Edhe në Kosovë është gati e kuptueshme për të gjithë që Gjykata Speciale ishte një mashtrim i specializuar, të cilën nuk e meritonim. Ishte e kuptueshme besoj edhe për ata që përkohësisht janë në Hagë, mirëpo përballë interesit shtetëror nuk mërzhiteshin për fatin personal. Por, tash kur edhe arsyeja e vetë ekzistencës së kësaj gjykate është e komprometuar, e shtrembëruar dhe po abuzohet me të, na ka mbetur ta kuptojmë edhe PSE-në e saj.

E nisën si hetim për t'i zbardhur pretendimet e Dick Martyt dhe përfunduan pa asnjë pretendim të tij në

aktakuzën ndaj krerëve të UÇK-së.

Kosova nuk kishte si të mos pajtohej që të hetoheshin ato pretendime dhe bashkësia ndërkombëtare nuk kishte si të mos i mbështeste hetimet rreth tyre. Por, vetë Gjykata Speciale tash po e konfirmon që raporti i Dick Martyt ishte një mashtrim, duke mos e përfshirë asnjë pretendim të tij. Gjithashtu edhe vetë procesi i administruar nga kjo gjykatë, që nga publikimi i njoftimit për dorëzimin e aktakuzës deri te mosdorëzimi i saj as pas një viti, po dëshmohej çdoherë e më shumë që është vazhdimësi e një mashtrimi të specializuar. Hashim Thaçin e kishin me shumë nguti ta dërgonin në Hagë dhe të mos e linin ta përfundonte as mandatin e presidentit. Por, sot, një vit pas, as hetimet ende nuk i kanë mbyllur dhe as aktakuzën e plotë ende nuk ia kanë dorëzuar. Ky është absurditet në vete dhe nuk ka lidhje me drejtësinë vendore dhe atë ndërkombëtare.

E hoqën nga skena politike një president të zgjedhur, pa i mbyllur as hetimet, pa qenë të gatshëm as për gjykim dhe shkoi një vit duke i mbajtur që të katërtit në paraburgim. Aq jobindëse i kanë arsyetimet, sa që po e trajtojnë me rrezik ikjeje një ish-kryeministër e ish-president, që ka hequr dorë edhe nga imuniteti dhe pozita si president për t'u përballur me këtë "drejtësi". Po shohin mundësi të pengimit të drejtësisë prej tyre kur as në

kapacitetet me të larta shtetërore si kryeministër e president apo si ish-kryeparlamentarë, si njerëzit më të pushtetshëm në Kosovë, asnjëherë nuk penguan, por gjithmonë bashkëpunuan, duke e ditur që vetë ishin shënjestrat kryesore.

Për më tepër, Hashim Thaçi si shënjestër kryesore e Dick Martyt ishte edhe njeriu që u pajtua të themelohej kjo gjykatë, sepse në çfarëdo alternative, Kosova patjetër do të duhej të ballafaqohej me raportin famëkeq të tij. Megjithatë, as pas dhjetë vjetësh hetime, asnjë fjalë për trafikimin e organeve nuk është përfshirë në asnjërin prej atyre aktakuzave të përgjithësuara që i ka lëshuar Gjykata Speciale.

Paraburgimi i tyre po vazhdon të arsyetohet me argumente të dobëta, me shqetësime të përgjithësuara dhe të hiperbolizuara për rrezikun e ikjes dhe frikësimit të mundshëm të dëshmitarëve kur paradoksalisht, sipas mbrojtjes, as emrat e dëshmitarëve ende nuk dihen. Kjo ishte baza për të cilën ishin pajtuar Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare që të hetohet dhe gjykohej, sepse këto ishin edhe pretendimet e Dick Martyt. Ndërsa, në vend të përfshirjes së pretendimeve të tij, Gjykata Speciale përfundoi në disa aktakuza të dobëta dhe të pabazuara ku inkriminohet Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për krime të supozuara që nuk u ndoqën as nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-

Jugosllavinë dhe nuk kanë lidhje as me raportin e Dick Martyt.

Kjo konfirmon edhe njëherë që Dick Marty mashtroi në Këshillin e Evropës dhe Kosova i vuajti padrejtësisht pasojat tepër të dëmshme të raportit të tij.

Përndryshe, është e paimagjinueshme që në terrene të tilla, kaq të dobëta, një gjykatë ta mbështeste paraburgimin e pacaktuar në cilindo prej shteteve që e financojnë Gjykatën Speciale. Por, ironikisht, kjo po ndodh në shtëpinë e drejtësisë midis Hage vetëm për ish-udhëheqësit e UÇK-së dhe ish-udhëheqësit e shtetit të Kosovës.

Është e paimagjinueshme që kritikën e një presidenti për padrejtësitë ndaj Kosovës, në cilindo prej shteteve që e financojnë këtë gjykatë, të interpretohen si pengim i drejtësisë. Por, ato u interpretuan kështu në rastin e ish-kryeministrit dhe ish-presidentit të Kosovës për ta arsyetuar mbajtjen e tij në paraburgim.

Përkundër që Gjyqtari i Procedurës Paraprake e ka lejuar prokurorin të redaktojë një pjesë të madhe të aktakuzës, u bën një vit në paraburgim dhe ata ende nuk janë të informuar saktësisht se cilat akuza konkrete rëndojnë mbi ta. Çdo kund në botë, qëllimi i aktakuzës është që të informohet edhe i akuzuari për akuzat ndaj tij. Por, edhe pas një viti në paraburgim, Gjykata Speciale ende po i mban të fshehura akuzat konkrete ndaj tyre. Çdo kund në botë sistemi i drejtësisë është i ndarë në disa shtylla dhe respektohet njëfarë Kodi i Sjelljes Profesionale, por në Gjykatën Speciale prokurorët dhe gjyqtarët edhe koordinohen pa prezencën e palës mbrojtëse. Çdo kund në

botë, Avokati i Popullit mbron interesat e të akuzuarve, ndërsa në rastin e Gjykatës Speciale edhe ai i mbron interesat e prokurorisë dhe të gjykatës.

Bashkësia ndërkombëtare e detyroi Kosovën ta themelonte Gjykatën Speciale për t'i adresuar akuzat e rreme të raportit të Dick Martyt. Por, kur ata nuk ishin në gjendje të gjenin prova për t'i mbështetur ato pretendime, Zyra e Prokurorit të Specializuar doli me pretendime të reja për ta justifikuar mashtrimin e tyre. Një mashtrim i tillë nuk do të ishte toleruar në asnjë shtet të Bashkimit Evropian, por po tolerohet gjithmonë kur viktimat të mashtrimit janë shqiptarët.

Shqiptarët janë të vetmit në rajon që nuk i janë shmangur asnjëherë drejtësisë ndërkombëtare. Jemi të vetmit në tërë Ballkanin Perëndimor që jemi lënë edhe të izoluara, të mashtruar dhe të gjykuar pa i përfillur as të drejtat e të akuzuarve dhe pa i vrarë as ndërgjegjja evropiane.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tyre që po mbahen në Hagë po i mungojnë Kosovës. Por, pas daljes së parë publike të UÇK-së në nëntor, dy dekada pas përfundimit të luftës, kjo betejë e tyre e re në të ardhmen do të kujtohet si beteja e fundit e nëntorit të lavdishëm për mbrojtjen e luftës së drejtë dhe të pastër të UÇK-së.

Ata as nuk mposhtën e as nuk thyhen dhe ish-generali amerikan, Wesley Clark, i përshkroi më së miri në ditët e kaluara.

Kjo Gjykatë Speciale është sfidë që do të kalohet brenda pak vitesh. Dikush edhe mund ta shijojë e të kënaqet me të, por duhet ta dijë që pjesën tjetër të jetës mund ta kalojë i turpëruar.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ballkani dhe Drita luftojnë për pozitën e parë

Dy derbi do të zhvillohen në kuadër të javës së 13-të në BKT Superligë. Sot (e shtunë) në Suharekë, Ballkani dhe Drita. Trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu dhe sulmuesi Ardit Tahiri kanë paralajmëruar se do të luajnë për fitore. Ndërsa të dielën zhvillohet derbi mes Prishtinës dhe Gjilanit në stadiumin "Fadil Vokrri"

EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Dy skuadrat e para në renditjen tabelore në BKT Superligën e Kosovës në futboll, Ballkani dhe Drita do të përballen sot (e shtunë) në kuadër të javës së 13-të. Ballkani pësoi humbjen e parë në javën e kaluar nga Ulpiana dhe në këtë ndeshje do të luftojë për fitore në mënyrë që të rikthehet në pozitën e parë. Një organizim i madh pritet të bëhet edhe nga grupi i tifozëve të Ballkanit, "Xhebrailat". "Mobilizim total, ftojme të gjitha lagjet dhe mëhallët. Të shtunën na vjen FC Drita në Suharekë, ndeshje mjaftë

e rëndësishme, andaj arsye për mungesë nuk ka. 'Xhebrailat' prej orës 12:00 mbledhem tek fan-klubi, ku dhe do shpërndahen biletat. Merre shokun e hajde në tribunë", thuhet në njoftimin e "Xhebrailave". Për këtë ndeshje derbi është përgatitur maksimalisht edhe skuadra e Dritës. Në konferencën një ditë para ndeshjes foli trajneri i skuadrës gjilanase, Ardian Nuhiu, i cili ka thënë se janë përgatitur se si të luajnë në këtë ndeshje derbi. "E kemi një ndeshje të rëndësishme që duhet ta trajtojmë me përqendrim dhe vlerësim maksimal, sepse bëhet fjalë për një skuadër të mirë, që luan si grup



mirë dhe ka individë cilësor. Të shtunën takohen dy skuadra me shumë cilësi dhe viteve të fundit kanë luftuar për kreun e tabelës. Një derbi që kam besim ta arsyetojë epitetin e derbit dhe kam besim se do shohim futboll kualitativ. Më gëzon fakti që skuadra është mirë, djemtë kanë qenë të motivuar gjatë javës dhe kemi përgatitur një plan për mënyrën se si do luajmë, ku uroj

dhe shpresoj që nesër ta nxjerrim në praktikë atë plan", ka thënë Nuhiu. Për këtë ndeshje foli edhe sulmuesi Ardit Tahiri. Ky i fundit paralajmëroi se luajnë për fitore. "Ne e dimë rëndësinë e ndeshjes e së shtunës dhe poashtu nivelin e kundërshtarit. Jemi munduar dhe kemi punuar maksimalisht me përgatit për këtë ndeshje. Atmosfera në ekip është mjaft e mirë dhe shpresoj të fitojmë", ka

thënë Tahiri. Ballkani pozicionohet në vendin e dytë me 21 pikë, kurse Drita është në vendin e parë me një pikë me shumë. Sot zhvillohen edhe dy ndeshje tjera të javës së trembëdhjetë. Drenica e pret në stadiumin "Bajram Aliu", Ulpianën. Ndërkohe një ndeshje e jashtëzakonshme pritet të zhvillohet në mes Malishevës dhe Llapit, kurse të dielën nga ora 13:00 përballen Dukagjini-Feronikeli dhe superderbi Gjilani-Prishtina.

BKT Superliga - Java e 13

Të shtunën takohen:
13:00 Ballkani - Drita
13:00 Drenica - Ulpiana
13:00 Malisheva - Llapi

Të dielën takohen:
13:00 Dukagjini - Feronikeli
13:00 Gjilani - Prishtina

Distria mbetet pa medalje në Baku

BAKU, 5 NËNTOR - Distria Krasniqi nuk ka arritur të fitojë medalje në Grand Slam "Baku 2021". Pas medaljes së artës që e fitoi në Olimpiadën e Tokios, xhudistja e Kosovës shihej si favorite në këtë garë, por nuk ia doli të buzëqeshte prapë. Ajo e humbi përballjen kryesore për medaljen e bronzit në garën që

po mbahet në Azerbajxhan. Xhudistja e Kosovës e humbi luftën për medaljen e bronzit përmes repesazhit pasi u mposht me Ippon nga rusja Anastasia Polikarpova. Dominimi në këtë luftë ishte i pamjaftueshëm për "Disin" dhe asaj i kushtoi një pakujdesi në "golden-score". Paraprakisht,

"Disi" në rrethin e parë e mposhti me Wazzaari japonezen Nanako Tsubone, e në të dytën u mposht me Ippon nga hungarezja Pupp Reka. Krasniqi më pas e mundi me Ippon belgen Amber Ryheul në meçin e parë të repesazhit para se ta humbiste meçin kryesor për medalje.



Gliha publikon listën e futbollistëve për dy ndeshjet e nëntorit



PRISHTINË, 5 NËNTOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Primozh Gliha, e ka bërë publike listën e futbollistëve që do t'i ketë në dispozicion për dy ndeshjet e këtij muaji. "Dardanët" më 10 nëntor e zhvillojnë miqësoren

kundër Jordanisë në stadiumin "Fadil Vokrri", ndërsa katër ditë më pas e luajnë ndeshjen e fundit kualifikuese për Botërorin 2022 kundër Greqisë në Athinë. Stërvitja e parë mbahet të hënën, në orën 18:00, në stadiumin "Fadil Vokrri".

LISTA E FUTBOLLISTËVE

Arjanet Muriq, Mërgim Vojvoda, Betim Fazliji, Florent Loshaj, Blendi Idrizi, Zymer Bytyqi, Elbasan Rashani, Visar Bekaj, Amir Rrahmani, Mirlind Kryeziu, Besar Halimi, Toni Domgjoni, Lirim Kastrati, Edon Zhegrova, Vedat Muriqi, Samir Ujkani, Fidan Aliti, David Domgjoni, Herolind Shala, Valon Berisha, Bersant Celina, Milot Rashica, Astrit Selmani.

Presidenti i KOK-ut pret delegacionin e mundjes

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka pritur delegacionin e mundjes, pas suksesit të arritur në Kampionatin Ballkanik dhe Mesdhetar për të Rinj, të

mbajtur në Xanthi të Greqisë. Mundësit tanë fituan katër medalje të bronzta. Në Ballkanikun U-15 me medaljen e bronzit u stolisën Jon Ramadani dhe Adriatik Berisha, ndërsa në Mesdhetar,

grupmosha junior, të bronzit të fituan Egzon Xhoni dhe Auron Sylja. Presidenti Krasniqi ka përgëzuar mundësit për medaljet e fituara, duke iu uruar fat dhe suksese edhe në garat e

ardhshme ndërkombëtare. Kryetari i Federatës së Mundjes së Kosovës, Naim Muja, duke falënderuar presidentin Krasniqi për pritjen, theksoi se mundësit tanë i pret e ardhme e ndritur.



Xavi emërohet trajner i Barcelonës

Barcelonë, 5 nëntor - Tashmë është zyrtare: Xavi Hernandezi është trajneri më i ri i skuadrës së Barcelonës. Skuadra Al-Sadd, ekipi aktual i Xavit, ka njoftuar lajmin në rrjetet sociale. "Administrata e Al-Sadd ka arritur një marrëveshje me FC Barcelona,

pas pagesës së klauzolës së lirim, të parashikuar në kontratën e Xavit. Ne kemi rënë dakord të bashkëpunojmë me Barcelonën në të ardhmen. Xavi është një pjesë e rëndësishme e historisë së Al-Sadd dhe i urojmë sukses. Ai

na informoi disa ditë më parë se dëshironte të shkonte te Barcelona në këtë moment të veçantë për shkak të fazës kritike që po kalon klubi i vendlindjes dhe ne e kuptojmë këtë, ndaj vendosëm të mos ndërhyjmë në rrugën e tij. Xavi dhe familja e tij do të

vazhdojnë të jenë të mirëpritur në Doha. Marrëdhënia jonë do të vazhdojë", thuhet në njoftimin e Al-Sadd. Xavi do të marrë një pagë më të ulët se tek Al-Sadd, pasi Barcelona ka paguar klauzolën e lirim prej pesë milionë eurosh.



Sfida interesante në xhiron e tretë të Ligës Unikea

PRIZREN, 5 NËNTOR - Xhiroja e tretë e Ligës Unike që zhvillohet në fundjavë do të sjellë takime mjaft interesante. Prizreni 16 do të përballet me Rahovecin, që nuk e ka nisur mirë këtë edicion, por kërkon këndelljen. Prizrenasit kanë një fitore dhe një humbje, kurse Vreshtarët dy humbje në dy ndeshje. Ky takim ka vlerë të dyfishtë, pasi rezultati llogaritet edhe në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Të shtunën zhvillohet klasikja e basketbollit shqiptar në mes të Vllaznisë dhe Tiranës, dy skuadra me traditë në basketbollin shqiptar.

Në Ligën Unike shkodranët kanë dy humbje, kurse tiranasit një fitore dhe një humbje. Sfidë interesante pritet ndërmjet Pejës dhe Kamza Basket. Pejanët kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, ndërsa skuadra nga Kamza, e ka nisur mirë edicionin e ri në Ligën Unike me dy fitore, kurse verdhezinjtë kanë një fitore dhe humbje. Takimi i fundi i



xhirus është në mes të Teutës dhe Golden Eagle Ylli, dy skuadra që ishin ndeshur në gjysmëfinale të Superkupës Mbarëkombëtare, ku kishin fituar therandasit, që janë favoritë edhe për këtë ndeshje. Skuadra nga Durrësi ka një fitore dhe një humbje, ndërsa Ylli ka dy fitore në dy ndeshje.

LIGA UNIKE - XHIRO 3

Të shtunën takohen:

17:00 Prizreni 16 - Rahoveci
19:00 Vllaznia - Tirana Neptun

Të dielën takohen:

17:00 Peja - Kamza Basket
19:00 Teuta - Golden Eagle Ylli

Cockfield Jr, MVP i xhiros së nëntë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Xhiroja e nëntë në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll ka dhuruar ndeshje interesante. MVP i xhiros së nëntë është zgjedhur Taurus Cockfield Jr i Trepçës, i cili kundër Prizrenit 16 realizoi 20 pikë, derisa kishte edhe katër kërcime, nëntë asistime, dy topa të vjedhur dhe një bllokadë. Organizatori ishte ndër më meritoret për fitoren e mitrovicasve. Edhe qendra e mitrovicasve, Andrew Gordon, zhvilloi një lojë të mirë me 14 pikë, tetë kërcime, një asistim, dy topa të vjedhur dhe gjashtë bllokada.

Golden Eagle Ylli shënoi fitore të rëndësishme ndaj Bashkimit, ndërsa qendra e Kosovës, Gëzim Morina, zhvilloi një lojë shumë të mirë, me 22 pikë, tri kërcime, dy asistime, dy topa të vjedhur dhe një bllokadë. Sigal Prishtina fitoi derbin ndaj rivalëve të vjetër, Pejës në udhëtim, ndërsa



organizatori i prishtinasve, Wendell Mitchell, ishte ndër basketbollistët më të dalluar në parket me 24 pikë, tri asistime, një top të vjedhur dhe një bllokadë. Rahoveci mundi Dritën për herë të dytë në këtë edicion, ndërsa basketbollisti më i mirë në parket ishte Altin Morina i

Vreshtarëve me 31 pikë, shtatë kërcime, tetë asistime dhe tre topa të vjedhur. Top pesë i xhiros së nëntë: Taurus Cockfield dhe Andrew Gordon të Trepçës, Gëzim Morina i Golden Eagle Yllit, Wendell Mitchell i Sigal Prishtinës dhe Altin Morina i Rahovecit.

SHKURT

Tenisti austriak: U vaksinova në mënyrë që të luaj në Australian Open

Tenisti austriak Dominic Thiem, aktualisht numri 21 në botë dhe fitues i grand slam të US Open, ka deklaruar se ka kryer vaksinën kundër Covidit në mënyrë që të luajë në Australian Open, turneun e parë të madh të vitit 2022, që zhvillohet në Melburn (17-30 janar). Thiem nuk luan prej disa muajsh për shkak të një dëmtimi në pulsin e dorës, por synon të jetë në formë kur të nisë sezoni i ri. "Do të luaj në Abu Dhabi në dhjetor, në mënyrë që të testoj veten dhe të jem gati për Australian Open", ka thënë Thiem. "Vaksina është e nevojshme për të qenë pjesë në këto dy evente, ndaj u vaksinova. Mendoj se jam në rrugën e duhur për t'u rikthyer në majë. Së shpejti rinis stërvitjen me ritëm të plotë", u shpreh Dominic Thiem, një nga tenistët më të mirë në botë. Ende në dilemë prania e numrit 1 në botë, serbit Novak Djokovic në Australian Open, pasi nuk është i vaksinuar. Në këtë turne do të lejohen vetëm të vaksinuarit, ndërsa të tjerët do të kryejnë 14 ditë karantinë dhe më pas do të kenë mundësi të luajnë.

Newcastle përgatit 55 milionë euro për Ter Stegenin

Newcastle Unitedi është gati të paguajë 55 milionë euro për portierin e Barcelonës, Marc-Andre ter Stegen. 29-vjeçari zhvilloi 291 paraqitje për gjigantin katalunas që kur arriti nga Borussia Monchengladbach në vitin 2014 dhe ka edhe katër vjet kontratë të mbetur në "Camp Nou". Ka spekulime për të ardhmen e gjermanit, me Manchester Cityn që thuhet se ka interesim. Sidoqoftë, "El Nacional" raporton se interesimi më i madh vjen nga Newcastle, që e ka prioritet Ter Stegen për portën. Shekët e Arabisë Saudite janë gati edhe të paguajnë 55 milionë euro, derisa Barcelona do të jetë e detyruar të negociojë shkakun e problemeve financiare. Por, skuadra e Premierligës do ta ketë të vështirë ta bindë portierin ngaqë për momentin renditet në pozitën e parafundit në tabelë. Këtë edicion për Barcelonën, Ter Stegen ka pranuar 15 gola në 13 ndeshje.

PSG-ja planifikon transferimin e Kroosit

Skuadra e PSG-së po planifikon transferimin e Toni Kroosit nga Real Madridi. 31-vjeçari po luan sezonin e tetë në Madrid ku ka bërë 327 paraqitje, ka shënuar 22 gola dhe ka dhuruar shumë asistime. Ai ka fituar 13 trofe, veçuar tri herë me radhë Ligën e Kampionëve. Sipas "El Nacional", Paris Saint-Germain ia ka vënë syrin Toni Kroosit dhe do ta dëshironte në skuadër në verën e vitit 2022. Pasi mori Sergio Ramosin, gjiganti i Ligës 1 beson se mund ta joshë me para edhe Toni Kroosin, për të cilin Manchester City gjithmonë ka qenë i interesuar.

Cavani shihet si zëvendësues i Agueros

Drejtuesit e Barcelonës janë fiksuar pas një objekti për zëvendësimin e Sergio Agueros, i cili do të mungojë për një kohë të gjatë për shkak të aritmisë në zemër. Bëhet

fjalë për Edinson Cavanin, që pritet të mbërrijë në janar në "Camp Nou", pasi me nënshkrimin e Cristiano Ronaldos me Manchester Unitedin, mundësitë e tij për të

qenë në fushë janë zvogëluar. Përveç kësaj, kontrata e uruguaiianit me "Djajtë e Kuq" përfundon në fund të sezonit, që do të thotë shumica që do të paguhej për kartonin e tij nuk

do të ishte e lartë. Megjithatë, ai do të duhet të pranojë një ulje të konsiderueshme të pagës, pa harruar faktin që duhet edhe miratimi nga trajneri i ardhshëm, Xavi Hernandez,

për blerjen e tij. Në një situatë identike me atë të "El Matador" është edhe Lacazette, një tjetër opsion i trajtuar nga bordi drejtues, por që "ngroh" më pak se Cavani.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

ZYRTAR/E ADMINISTRATIV/E PËR KOMISIONE TË PËRHERSHME

Numri i pozitave: 2 (dy vende pune)

Nr. ref: 06/2021

Kohëzgjatja e Kontratës: 6 muaj, me mundësi vazhdimi (Orar i Plotë, Zëvendësim i Pushimit të Lehonisë)

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe Komisioneve të përherëshme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të Komisioneve të përherëshme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjeve të Komisioneve të Përherëshme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e rakimeve;
- Mirëmbanë dosjet e Komisioneve të Përherëshme;
- Ndihmonë anëtarët e Komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlihen me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe Shërbimit Profesional në përgjithësi.

Mbikëqyrja e drejtpërdrejtë: Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Të ketë të kryer Fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
- Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;

Paraqitja e kërkesave:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave. Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga ueb faqja e OMK-së, www.omk-rks.org dhe të gjitha aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjen e letërnjoftimit, kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të konkursit, mund të dorëzohen:

- Përmes e-mail adresës info@omk-rks.org apo
- Përmes postës në adresën "Instituti A" QKUK, kati II, 10 000 Prishtinë, RKS

Në subjekt të email-it të ceket pozita për të cilën aplikoni dhe emri, mbiemri juaj!

Aplikacionet e dërguara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit dhe do të jetë i hapur nga data: 05.11.2021 deri më 22.11.2021, ora 16:00.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038 / 544-872.

Konkursi dhe aplikacioni për punësim janë të publikuara edhe në Ueb-Faqen e Odës: <https://omk-rks.org/>



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Fadile Rahmani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qiriazi " Prizren.
- ▶ Teuta Binaku shpall të pavlefshme diplomë e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ Ymer Aliu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "28 Nentori " Dragash.
- ▶ Neshat Elshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- ▶ Edona Kastrati shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Lumnije Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Avdyll Frasheri " Prizren.
- ▶ Auto Taxi "Adnan Smajli" shpalle te pavlefshme certifikaten e biznesit me nrb: 70875373.
- ▶ Liridon Buqaj shpall te pavlefshme certifikaten shtetore shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ D.P.T "Selaci" shpalle te pavlefshme certifikaten e TVSH-se me numer :330438590.
- ▶ Ali Fanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Heronjet e Lumes " Vermic.
- ▶ Bejtush Cimili shpalle te pavlefshme dëftesen e shkolles fillore" Trepca" Stanterg.
- ▶ Gjerm Memqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhd e Hasit.
- ▶ Ferdane Bilalli shpalle te pavlefshme dëftesen e shkolles fillore " Shmesi Ahmeti".
- ▶ Durim Neshati shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Arben Asllanaj shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- ▶ Kadri Kadrijaj shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Burim Beka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- ▶ Ikrime Ibrahim shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Shkëlqim Beka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike " Kadri Kusari.
- ▶ Blerim Ibrahim shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

